

LOANWORDS IN THE LEXIS OF POMOLOGY HUAZIMET NË LEKSIKUN E PEMËTARISË

Hana DARDHISHTA¹

^{1*} *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

^{*} *Corresponding author e-mail: hana.rd@hotmail.com*

Abstract

This subject is about the lexis of pomology, for that reason this lexis is rich and gives an abundance of linguistic material, since the development of pomology as part of agriculture is quite rich. This paper treats the topic of loans in the lexis of pomology, including the direct etymology and linguistic aspect of some of the meanings in pomology. As a main drive to discuss this topic was the interest for loanwords and its etymology. In this case a particular group of words, which apart that they belong to a linguistic system they also function as terms of a specific terminological system – botany.

Also, of interest was for the influence and the relation of the Albanian language with other languages and vice versa, especially with the languages with which it has been in contact the most. Thus, when looking at the etymology, we come to a conclusion that the phenomenon of loanwords is also present in this group of words. Loanwords are well received in most cases and are often seen as a necessity in communication to the extent that they are used logically and for the benefit of communication and vocabulary of a language, however not abusing and not damaging a language by introducing foreign words out of place.

Keywords: *language, pomology, etymology, loanwords, lexis.*

Përmbledhje

Kjo temë është e lidhur me leksikun e pemëtarisë, nga shkak që ky leksik është i pasur dhe jep një material mjaft të begatë gjuhësor, duke pasur parasysh që zhvillimi i pemëtarisë si kulturë bujqësore është mjaft e pasur. Ky punim trajton çështjen e huazimeve në leksikun e pemëtarisë, përfshirë në mënyrë të tërthortë edhe etimologjinë dhe aspektin gjuhësor të disa fjalëve të pemëtarisë. Si motiv kryesor që më shtyu të trajtoj këtë çështje është interesimi për huazimet dhe prejardhja e tyre, në këtë rast të disa fjalëve që përveç se i përkasin sistemit gjuhësor, ato funksionojnë edhe si terma në suaza të një sistemi të posaçëm terminologjik, të quajtur botanikë.

Gjithashtu interesimi qëndronte edhe për ndikimin dhe marrëdhëniet e gjuhës shqipe me gjuhët e tjera dhe anasjelltas, sidomos me ato gjuhë me të cilat ka qenë më së shumti në kontakt. Kështu duke parë prejardhjen e fjalëve kuptojmë se, dukuria e huazimit është e pranishme edhe në këtë grup fjalësh. Huazimet janë të mirëpranuara në të shumtën e rasteve dhe shpesh herë shihet edhe si domosdoshmëri në komunikim, por deri aty ku kjo përdoret me logjikë dhe në dobi të komunikimit e pasurimit të gjuhës, pa shkuar në shpërdorimin e saj dhe pa kaluar në dëmtrim të gjuhës me futjen e fjalëve të huaja vend e pa vend.

Fjalët kyçe: *gjuhë, pemëtari, etimologji, huazime, leksik.*

Etimologjia e këtyre fjalëve gjithashtu do të jetë pjesë përbërëse e kësaj trajtese. Fjalori etimologjik i një gjuhe pasqyron me një pamje të përmbledhur historinë e asaj gjuhe dhe me një mënyrë dhe fatet historike të popullit që e flet a që e ka folë atë gjuhë. Për historinë e jashtme të shqipes gjatë periudhave të ndryshme historike vijnë në vështirësi huazimet që ka marrë kjo prej gjuhëve fqinje në epokat e ndryshme. Huazimet janë dukuri e zakonshme në të gjitha segmentet e gjuhës. Huazimet ndonjëherë përshtaten, por ka edhe huazime të drejtpërdrejta apo të pastra.

Për etimologjinë e disa fjalëve Eqrem Çabeji thekson se huazimet latine të shqipes me karakterin e tyre arkaik tregojnë se kanë depërtuar herët në këtë gjuhë. Si dëshmi për huazime të vjetra është ndërrimi i zanores -ō latine në -e shqipe. Nëse marrim etimologjinë e fjalës pemë, në gjuhën e sotme shqipe ka dy kuptime, kuptimi i parë ka ardhur prej latinishtes pomum që do të thotë mollë. Më vonë ky kuptim është përgjithësuar, jo vetëm si mollë por edhe si dru frutorë, dhe në fund u përgjithësua edhe me kuptimin e pemës në përgjithësi, p. sh.: *Mbjellja e pemëve*.

Pra, drurët frutorë janë fusha në të cilën ka ndërhyrë njeriu, i ka përdorur për vete dhe i ka kultivuar për vete, por realisht natyra nuk i ka pasur të tilla, p. sh.: mollën, dardhën, gështenjën etj. Ne kur flasim për frutat e kultivuara nuk mund t'i lëmë anash edhe ato të egrat. Pra ideja është se nuk mund të bëhet një dallim i prerë ndërmjet drurëve dhe pemëve frutore sepse një pjesë e madhe e pemëve frutore kanë drejtpërdrejtë prejardhje nga drurët e egër. Nëse nuk hahet gështenja e egër ne nuk mund të anashkalojmë dhe të mos e përmendim fare, gjuha shqipe e ka kaluar emrin e gështenjës reale tek gështenja e egër, që në të vërtetë edhe njëra edhe tjetra janë bimë të ardhura dhe i përkasin familjeve të ndryshme.

Sa u përket frutave të cilat konsiderohen të egra, si: boronica (*Vaccinium myrtillus*), molla e egër (*Mallus sylvestris*), murrizi (*Crataegus monagina*), thana (*Cornus mas*), gështenja (*Castanea sativa*), trëndafili i egër (*Rosa canina*), manaferra (*Rubus fruticosus*), mjedra (*Rubus idaeus*) etj., në botë llogariten edhe si bimë mjekësore aromatike njëkohësisht kanë rëndësi ekonomike dhe janë të kërkuara në tregun botëror.

Përveç frutave të cilat ekzistojnë si të egra, e më pas edhe të kultivuara ekzistojnë edhe fruta të cilat për popullin shqiptarë e më gjërë janë bërë të njohura shumë vonë. Këto fruta, siç mund të jenë: avokado, ananasi, aronia, banania, grejpfruti, guava, kivia, mango, marakuja, noni, papaja etj. për popujt e vendeve tona janë fruta të reja. Karakteristikë gjuhësore është se, këto fruta (të kultivuara në vende me kushte tjera klimatike) kanë hyrë në gjuhën tonë bashkë me emërtimet e tyre (të huaja). Përveç kësaj na paraqitet ekzistenca e emërtimeve të dyfishta apo sinonimia, për shembull: *kivia-aktinidia*; *qitro-grejpfrut*; *kakia-molla japoneze*.

Sinonimet në këtë rast shpesh përbëjnë fjalët me origjinë të huaj, dhe kanë përdorim paralel, për shembull fjala grejpfrut rrjedh nga gjuha angleze, më saktësisht është një huazim nga anglishtja, ndërsa emri qitro është huazim më i vjetër se huazimi grejpfrut, dhe vjen nga gjuha greke, përmes latinishtes. Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe mund të gjendet termi qitro, por jo edhe termi grejpfrut. Edhe emërtimi aktinidia është huazim më i vjetër nga latinishtja, që në sistemin botanik ekziston si term, ndërsa në sistemin gjuhësor kjo fjalë ka një përdorim relativisht të kufizuar, edhe atë më së shumti në nivel dialektor.

Ndërsa vendin e saj në sistemin gjuhësor për emërtimin e të njëjtit term e ka zënë apo e ka marrë huazimi i kohës më të re kivi që vjen nga anglishtja. Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980) nuk mund të gjendet asnjëra nga këto leksema, që në jetën e përditshme dhe në fjalorin e popullit ekzistojnë dhe përdoren nga të gjithë folësit. Sa i përket sinonimeve *kakia* dhe *molla japoneze*, kemi të bëjmë me leksemë të huaj dhe togfjalësh vendor. Edhe këto dy emërtime të huazuara nuk i gjejmë në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980), ndërsa gjendet si hurma.

Fjala kakia është huazim nga gjuha japoneze dhe funksionon më së shumti vetëm në sistemin terminologjik, ndërsa përdorim më të shpeshtë, sidomos tek folësit e gjuhës shqipe këtu tek ne, gjen shprehja popullore molla japoneze. Etimologjia e këtij togfjalëshi është shumë e thjeshtë: fjala mollë vjen si rezultat i metaforës gjuhësore, duke pasur të njëjtën formë, madhësi dhe ngjyrë si të mollës. Ndërsa pjesa e dytë e shprehjes siç është fjala japoneze, tregon prejardhjen gjeografike të këtij fruti subtropikal, siç është Japonia, por që në kohët e sodit ky frut kultivohet edhe tek ne, më saktësisht në pjesën jugore të Maqedonisë, por edhe më gjërë në rajon.

Interesimi i njeriut për frutat nuk ka të ndalur, nga fakti që njeriu me anë të shartesave të ndryshme ka arritur të bëjë përfitimin e pemëve të reja frutore, siç mund të jenë: kumkvati, pepino, curuba, nashi (që duket si molla, është krijuar me shartimin e mollës dhe dardhës, që ka formë molle, ndërsa shije dardhe), kivano etj. Për shkak të globalizimit është bërë e mundshme që edhe tek shqiptarët të hyjnë në përdorim frutat të cilat kanë qenë të panjohura për popullin tonë. Është e natyrshme që pjesa më e madhe e tyre nuk njihen si drurë, por njihen vetëm si fruta, dhe është krejt normale që emrat e tyre të jenë edhe të huaj.

Çështja themelore e të gjitha këtyre fjalëve të huaja është se mbi ç'trajtë po nguliten në gjuhën shqipe, apo si i përvetësojmë në gjuhën shqipe nga ana fonetike dhe morfologjike? Huazimet e reja hyjnë herë pas here në gjuhë, në varësi të rrethanave, të zhvillimit të vendit në të gjitha aspektet, të lëvizjes dhe të marrëdhënieve të drejtpërdrejta me popuj e me gjuhë të tjera, fqinje ose jo. Fjala e huazuar, kur hyn në gjuhën shqipe, u përshtatet rregullave gjuhësore të saj. Kështu, edhe në fushën e huazimeve në përgjithësi, duket që shqipja është mjaft prodhimtare. Ajo merr fjalën bazë prej gjuhës së huaj dhe, me anë të përzierjes me elemente të vendit ose me të tjera të huaja, me mjete të ndryshme të fjalëformimit, me marrje e zhbartje ose këmbime prefiksesh e sufiksesh, me zberthim fjalësh me anë të terminologjisë popullore etj., përftohen forma të reja fjalësh, emërtimi i të cilave si huazime ka vetëm një vlerë relative.⁴⁰

Huazimet kanë gjetur shtrirje të gjerë në të gjitha rrafshet gjuhësore në gjuhën shqipe dhe si rrjedhojë edhe terminologjia nuk kishte si ta shmangte një dukuri të tillë. Depërtimet e fjalëve të huaja në gjuhën shqipe i kemi gati në të gjitha fushat dhe terminologjinë që ato përdorin, të tilla si: terminologjia administrativo-juridike, terminologjia gjuhësore, terminologjia e kulinarisë, terminologjia sportive, terminologjia informatike, terminologjia ekonomike, terminologjia e mjekësisë etj.

Përmendja e disa produkteve të caktuara nga gama e gjërë e ushqimeve, kurrsesi nuk mund të jetë rastësi dhe e paqëllimtë. Njerëzit, që herët e kishin kuptuar rëndësinë e frutave në jetën e tyre si dhe për shëndetin e tyre. Madje mund të themi se, janë këto ushqime që ruajnë shëndetin e njeriut. Kështu, filluan të bëjnë edhe përpunimin e tyre me qëllim që të mund t'i konsumojnë edhe gjatë sezonit të dimrit. Kështu prej mollës si prodhim kemi komposton (ëmbëlsirë e lëngshme e përgatitur me pemë të thata ose të njoma, të ziera për pak kohë në ujë me sheqer, p. sh.: Komposto me kumbulla, me qershi, me mollë, me kajsi), pastaj kemi prevedenë (lloj reçeli që përgatitet duke zier pemë me sheqer deri sa të bëhet lëng i trashë, i cili ngrin si një masë pak a shumë e tejdukshme, p. sh.: *Prevede ftonjesh apo mollësh, kumbullash*).

Prej frutave si fiku, kumbulla, luleshtrydhja e të tjera bëhet gliko (reçel i përgatitur në shtëpi, me kokrra të plota pemësh, p. sh.: *Gliko qershie, kumbulle, kajsie, fiku, arre*), pestil (lëng a qull kumbullash të ziera që hapet në tepsi, thahet në diell dhe përdoret për t'i dhënë gjellës një shije të veçantë pak si të athët, p. sh.: *Petë pestili. Mish me pestil. I bëri kumbullat pestil*. Kjo fjalë që në gjuhën shqipe ka hyrë nga gjuha turke pestil, sipas Kamus'I osmani II, 325, nga lat. pastilla. Khs.

⁴⁰ E. Çabej, Gjendja e sotme dhe detyrat e etimologjisë së gjuhës shqipe, në: Studime gjuhësore I, Prishtinë 1976, f. 5-7.

dhe pers. pistil.,⁴¹ marmelatë etj. Fjala marmelatë rrjedh nga fjala portugeze për ftua, *marmelo*. Pra, në gjuhën portugeze ftoi quhet *marmelo* ku edhe rrjedh fjala marmelatë, sepse në fillim marmelata bëhej nga ftoi. Kumbullat për t'i ruajtur dhe për t'i pasur edhe gjatë sezonit të dimrit i kanë tharë dhe si të tilla i kanë emërtuar me emrin hoshaf (pemë të thata që përdoren gjatë sezonit të dimrit, *hoshaf kumbullash, hoshaf mollësh, hoshaf dardhash, hoshaf thanash*, p. sh.: *Hoshaf me pala pala fiku të ziera me ujë e me sheqer. Hoshaf me rrush të thatë*. Gjithashtu kemi edhe hoshafkë (kumbull e zezë gjatore, që thahet e që përdoret gjatë sezonit dimëror, p. sh.: *Hoshafka të thata. Ziej hoshafka*. Etimologjia e fjalës *hoshaf* është nga gjuha turke hosáf, nëpërmjet persishtes khosháb, që do të thotë pers. hos „mirë” + ab „ujë” (ujë i andëshëm).⁴²

Pastaj kemi pekmez prej mani, rrushi (lëng i ëmbël pemësh, zakonisht prej rrushit, që trashet duke e zier në zjarr e pritët me vapem ose finjë, që përdoret si ushqim e mund të ruhet për një kohë të gjatë, p. sh.: *Pekmez rrushi (manash). Bakllava me pekmez. Bëj (lyej) bukën me pekmez*. Sa i përket etimologjisë së kësaj fjale llogaritet me prejardhje turke pekmez, e kjo me prejardhje nga gjuha perse bekmaç). Prej frutit të limonit kemi limonadën (pije freskuese e athët, që bëhet me lëng limoni, me ujë e me sheqer, një gotë a një shishe me këtë pije, p. sh.: *Shishe limonade. Një gotë limonadë. Piu dy limonada* etj.

Prapashtesa –adë, është prapashtesë me burim të huaj, më konkretisht me burim turk. Gjithashtu kemi edhe limontoz - acid si pluhur i bardhë, me shije të thartë, që gjendet në kokrrën e limonit e të disa bimëve të tjera dhe që përdoret në industrinë ushqimore, për prodhimin e barnave të ndryshme etj., p. sh.: toz limoni, acidi i limonit, acid citrik. Kjo fjalë përbëhet prej dy emrave që formojnë një emër të përgjithshëm (limon + toz prej tur. toz = pluhur), p. sh.: *I hedh limontoz. Tret pak limontoz*. Të mos harrojmë edhe fjalën reçel (kokrra pemësh a pemplash që zihen me sheqer derisa të trashet lëngu, p. sh.: *Reçel qershie apo kumbulle, pjeshke, fiku, ftoi, shalqiri, arre, rrushi, luleshtrydheje, manafërre*). Fjala reçel në gjuhën shqipe vjen nga turqishtja reçel, kjo nga pers. riçal, riçar. Pastaj kemi vishnjadhë për shurup të përgatitur nga lëngu i kokrrave të vishnjës.

Lëngjet e frutave, një pjesë prej tyre ka dhënë pasoja në gjuhë, janë krijuar fjalë ose janë huazuar, kurse në pjesën tjetër produkti lidhet me togfjalëshin, p. sh.: *lëng molle, lëng portokalli, lëng mandarine, lëng dardhe* (nuk kemi dardhadë, portokalladë apo molladë, sikur që kemi limonadë), *raki kumbulle, raki mani, vaj arre, vaj ulliri, vaj bajame* etj. Për qullin që del nga përpunimi i frutit, për fat të keq nuk ka një emër të përshtatshëm në gjuhën shqipe dhe për këtë arsye ka hyrë fjala angleze *smoothie*, p. sh.: *smoothie me avokado, smoothie me ananans, smoothie me banane* etj. Kështu, fjala *smoothie* na asocon në fruta, në një pije që merr trajtën e qulltë të frutave të kombinuar me përbërës të ndryshëm.

Pasqyrimi i këtyre fjalëve në fjalor vërteton atë që në gjuhë me kalimin e viteve bëhen ndryshime dhe futja e fjalëve të huaja nuk bën përjashtim, pra gjuha është vazhdimisht nën trysinë e tyre dhe një pjesë edhe përfshihen në fjalor. Gjithashtu në gjuhën shqipe kemi edhe të tilla huazime të cilat nuk ndodhen në fjalorët dhe nuk kanë krijuar çerdhe fjalësh. Sipas gjasave, këto fjalë mund të dalin nga përdorimi, pasi në gjuhën shqipe nuk kanë arritur të zhvillohen ose mund të përdoren nga një rreth i ngushtë folësish.

⁴¹ Dizdari, Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Tiranë, f. 394.

⁴² Po aty, f. 772.

Përfundimi

Depërtimi i fjalëve të huaja në përgjithësi në gjuhën shqipe mund të themi që kushtëzohet nga:

- Nevoja që ka shoqëria, e për pasojë edhe gjuha e saj, për të gjetur një emërtim për sende e koncepte të ndryshme, të cilat ajo nuk i ka.

- Trysnia që ushtrojnë popujt e tjerë në realitete të ndryshme, të tilla si: ekonomia, shoqëria, kultura etj.

Në gjuhën e një vendi lënë gjurmët e veta edhe ngjarjet historike, të cilat kanë formësuar qenësinë e tij në vite, me të gjitha përjetimet njerëzore individuale e kolektive. Sigurisht shqipja nuk bën përjashtim nga kjo dukuri. Pushtimet territoriale që i ka ndier populli shqiptar disa herë nga popuj të ndryshëm, kanë dhënë ndikimin e tyre edhe në gjuhë, si p. sh: pushtimi turk, nga gjuha e të cilit kemi huazuar mjaft fjalë. Për shkak të kohëzgjatjes së madhe të këtij pushtimi, një pjesë e këtyre fjalëve janë ngulitur në gjuhë, duke i rezistuar edhe kohës.

Mënyrë tjetër është shtegtimi i fjalës nga një vend në një tjetër, së bashku me sendin a me dukurinë, si në rastet apo shembujt e lartpërmendur. Pra, duhet të marrim fjalë të huaja që plotësojnë vendet bosh në gjuhën shqipe, por gjithmonë duke i përshtatur me strukturën e gjuhës shqipe dhe nuk duhet të pranojmë fjalë të huaja për të cilët ka gjegjëse në shqip.

Referencat

- [1]. Bindon, Mario, Fjaluer teknik bujqësues italisht-shqip dhe shqip-italisht, Tiranë, 1935.
- [2]. Çabej, Eqrem, Studime gjuhësore I, Prishtinë 1976.
- [3]. Demiraj, Shaban, Gjuha shqipe dhe historia e saj, SHBLU, Tiranë, 1988.
- [4]. Demiri, Mustafa, *Flora ekskursioniste e Shqipërisë*, Tiranë, 1981.
- [5]. Dizdari, Tahir, Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe, Tiranë, 2005.
- [6]. Fjalor i Gjuhës Shqipe (v. 1954), Ribotim nga “Botimet Çabej”, Tiranë, 2005.
- [7]. Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.
- [8]. Кипријановски, М., Арсов Т., Овощарство, Скопје, 2009.
- [9]. Lafe E., Caka N., Duro A., Rizaj M., punim studimor Terminologjia profesionale si veprimtari ndërdisiplinore dhe detyrat e Alb-shkencës, nr. 3-4, Shkup, 2014.
- [10]. Lyons, John, Hyrje në gjuhësinë teorike, Tiranë, 2001.
- [11]. Lloshi, Xhevat, Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht dhe latinisht-shqip, Shkup, 2010.
- [12]. Mitruhi, Ilia, Drurët dhe shkurret e Shqipërisë, Tiranë, 1955.
- [13]. Pemëtarja 1, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 2012.
- [14]. Sejdiu, Shefki, Fjalorth etnobotanik i shqipes, Prishtinë, 1984.
- [15]. Xhuveli, Luftër, Bimët dhe shqiptarët nga neoliti në shekullin 21, Tiranë, 2012.